



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
GJIROKASTER

Nr.282[31012-00081-85-2016].Regj.Them
Data e regjistrimi.29.03.2016

Nr.261.Vendimi
Data.27.04.2016

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Gjirokaster e perbere :

GJYQTAR: Elidon PAPAZISI

Asistuar nga sekretarja **Elvana Shabani** ne Gjirokaster me **date. 27.04.2016**, mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore ceshtjen administrative qe i perket :

PADITES : Dritan Kola “person fizik I regjistruar me Nipt –K32509689L,me vend te ushtrimit te aktivitetit lagje “18-Shtatori “Gjirokaster ,perfaqesuar nga administrator Dritan Kola .Perfaqesuar ne gjykim nga av.Arjan Sotiri.

TE PADITUR: 1. Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokaster.
2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Drejtoria e Apelimt Tatimor Tiranë .
Te perfaqesuara ne gjykim nga znj.Morsina Dhimitri me autorizim.

OBJEKTI: 1.Shfuqizimin tërësisht të Njoftim Vleresimit Tatimor per detyrimet tatimore Nr.6350Prot ,date 01.11.2015,ne vleren 100.000 lek,te Drejtorise Rajonale Tatimore Gjirokaster.
2.Shfuqizimin tërësisht të Vendimit Nr.39019/3Prot , datë 29.02.2016 të Drejtorisë së Apelimt Tatimor ,ne Drejtorine e Përgjithshme të Tatimeve Tirane .
3.Detyrimin e paleve te paditura ,te paguajne shpenzimet gjyqesore.

BAZA LIGJORE : Nenet 31 e vijues ,153,154 e vijues te Kodit te Procedures Civile ,Nenet 115 e vijues te Kodit te Procedurave Administrative ,Ligji Nr.49/2012 “Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative “Ligj Nr.7961 date 12.07.1995,Kodi I Punes “Ligji Nr.76976,date 07.04.1993”Per kundravajtjet Administrative

“Ligj Nr.9920,date 19.05.2008,”Per Procedurat Tatimore ne Republiken e Shqiperise “,I ndryshuar ,Ligj Nr.9136,date 11.09.2003,Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore e shendetsore ‘I ndryshuar,VKM Nr.77,date 28.01.2015,”Per Kontributet e detyrueshme dhe perfitimet nga sistemi I sigurimeve shoqerore sdhe sigurimi I kujdesit shendetsor “I ndryshuar ,Udhezim Nr.23,date 09.12.2014,”Per mbledhjen e kontributeve te detyrueshme te sigurimeve shoqerore e shendetsore.

Gjykata pasi mori provat shkresore, degjoi palet qe ne konkluzionet perfundimtare kerkuan: Paditesi -Pranimin e padise,pala e paditur rrezimin e padise.

VEREN

Se paditesi Dritan Kola ka paraqitur ne Gjykate padi kunder te paditurit Drejtoria Rajonale e Tatimeve Gjirokaster ,Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane me objekt dhe baze ligjore si me lart.

Nga hetimi gjyqesor u provua se:

Paditësi Dritan Kola me Status Ligjor Person fizik me nr. NIPTI K 32509689 L, përfaqësuar nga z. Dritan Kola në cilësinë e përfaqësuesit. Objekti i aktivitetit “Fabrikimi i bukës dhe i ëmbëlsirave të freskëta” i regjistruar si tatimpagues pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër në datën 13.08.2003.

Paditësi ka marrë dijeni për Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. 6350 Prot datë 01.11.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër nëpërmjet shërbimit postar (sipas shënimit në librin e dorëzimit të shkresave në Postë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër). Pasi është njohur me detyrimin që i ka lindur ndaj organit tatimor për gjobën në shumën 100.000 lekë për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore Periudha Tatimore Tetor 2015, dhe nuk ka qenë dakort me këtë detyrim ka ushtruar të drejtën e tij duke u ankuar në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, Tiranë.

Pas shqyrtimit administrativ të ankimit nga ana e saj kjo drejtori me Vendimin nr. 39019 / 3 Prot. datë 29.02.2016, protokolluar me nr. 1429 Prot. datë 03.03.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të aktit administrativ, objekt ankimi Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. 6350 Prot. datë 01.11.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër për gjobat “mosdeklarim punonjësi”, për shumat 100.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit”. Akti administrativ që kundërshtohet Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. 6350 Prot. datë 01.11.2015, është rezultat i Akt – Konstatimit me nr. 0412215 datë 28.09.2015, të mbajtur nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastër, gjatë kontrollit të ushtruar në ambjentet ku kryente veprimtarinë paditesi në datën 28.09.2015 .

Paditesi e kundërshton këtë vendim si një akt relativisht të pavlefshëm sipas K.Pr.Administrative pasi nuk provohet sipas procedurave të parashikuara në ligjin nr.9920 kryerja e një kundervajtje administrative, konkretisht shtetaset Gesjana Erindi dhe Malvina Bocia kanë kontrate mesimi profesioni me paditesin sipas nenit 17 të Kodit të Punes, pra nuk janë punonjëse me kontrate

pune dhe per pasoje paditesi nuk ka detyrimin ligjor per deklarimin e tyre. Kjo vertetohet nga kontratat per mesimin e profesionit date 25.09.2015.

Pala e paditur prapeson se vendimi eshte i ligjshem sipas motivacionit qe permban, per pasoje kerkon rrezimin e padise. Pretendimet e paditësit nuk qëndrojnë pasi akti administrativ që kundërshtohet, është një akt tërësisht i bazuar në procedurën që parashikon Ligji me nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi me nr. 24, i Ministrisë të Financave datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore për zbatim.

Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. 6350 Prot datë 01.11.2015, është rezultat i Akt – Konstatimit me nr. 0412215 datë 28.09.2015, të mbajtur nga grupi i kontrollit i Drejtorisë Rajonale Tatimore Gjirokastrë. Në datën 28.09.2015, ora 10:55, grupi i kontrollit në zbatim të Urdhër Pune me nr. 3698 Prot datë 07.09.2015, nga ora 08:00 deri në orën 20:00, kanë ushtruar kontroll në ambjentin ku kryente veprimtarinë paditësi dhe pas verifikimeve të rastit, në përfundim ka mbajtur në vend Akt – Konstatimin me nr. 0412215 datë 28.09.2015. Siç rezulton nga ky akt në momentin e kontrollit në ambjentin e ushtrimit të veprimtarisë ka qenë prezent si përfaqësues vetë paditësi Dritan Kola, i cili pasi e ka lexuar e ka nënshkruar aktin pa asnjë kundërshtim.

Kontrolli i ushtruar në ambjentin ku kryente veprimtarinë paditësi, është kryer tërësisht në respektim të dispozitave ligjore e konkretisht pikës 80.3 të Udhëzimit me nr. 24, të Ministrisë të Financave datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Referuar të dhënave nga Sistemi Informatik Tatimor C@TS CUSTOMS AND TAXATION SYSTEM E – SIG 027 / a “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, nr. 3 datë 11.11.2015, periudha tatimore Viti 2015, Muaji Nëntor, rezulton se punonjëset Gesjana Erindi dhe Malvina Bocia janë deklaruar nga paditësi pranë organit tatimor vetëm në datën 11.11.2015 dhe data e fillimit të punës pranë këtij subjekti është data 12.11.2015. Pra vihet re fare qartë se këto punonjëse janë deklaruar në organin tatimor si të punësuar pranë paditësit, pasi ka kaluar mbi një muaj nga data e ushtrimit të kontrollit nga drejtoria jonë, kjo sipas DEKLARATA “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” periudha tatimore Viti 2015, Muaji Nëntor, ndërkohë që paditësi mbart detyrimin ligjor për deklarim e çdo punonjësi 24 orë përpara fillimit të punës.

Mosdeklarimi i dy punonjëseve për efekt të ligjit tatimor vërtetohet nga DEKLARATA “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi” periudha tatimore Viti 2015, Muaji Shtator e deklaruar nga vetë paditësi, ku vihet re lehtësisht se nuk ka të deklaruar në organin tatimor punonjëset Gesjana Erindi dhe Malvina Bocia.

Në rastin konkret provohet qartë se subjekti ka kryer shkelje të ligjit duke mosdeklaruar të punësuarat në organin tatimor 24 orë përpara fillimit të punës, prandaj me të drejtë është penalizuar më gjobë në zbatim të nenit 119 pika 1 gërma b) të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

Ndaj aktit administrativ Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. 6350 Prot. datë 01.11.2015, paditësi ka ushtruar ankim administrativ në Drejtorinë e Apelimit Tatimor Tiranë. Nga ana e saj kjo drejtori pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e paraqitur, me Vendimin nr. 39019 / 3 Prot. datë 29.02.2016, ka vendosur “Lënien në fuqi të aktit administrativ, objekt ankimi Njoftim Vlerësimit për Detyrimet Tatimore nr. 6350 Prot. datë 01.11.2015, të Drejtorisë Rajonale

Tatimore Gjirokastër për gjobat “mosdeklarim punonjësi”, për shumat 100.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit”.

Me të drejtë Drejtoria e Apelit Tatimor ka lënë në fuqi aktin administrativ të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastër, pasi provohet qartë se subjekti ka kryer shkelje të ligjit. Paditësi të gjitha pretendimet që ngre për shfuqizimin e këtij akti administrativ i ka të pabazuara në ligj, pasi nëpërmjet nënshkrimit rregullisht të Akt – Konstatimi me nr.0412215 datë 28.09.2015, paditësi e pranon me vullnet të lirë këtë akt dhe bie dakort me përmbajtjen e tij, duke qenë se nuk ka shprehur asnjë kundërshtim në momentin e nënshkrimit. Madje megjithëse ka qenë prezent nuk ka bërë asnjë sqarim lidhur me situatën e pretenduar nga ana e tij, për punonjëset Gesjana Erindi dhe Malvina Bocia të gjetura në momentin e kontrollit. Kjo do të thotë se edhe vetë paditësi ka rënë daktort dhe ka pranuar se Akt – Konstatimi me nr. 0412215 datë 28.09.2015, është akt i hartuar në përputhje me ligjin dhe evidenton saktë situatën që ka ekzistuar në momentin e kontrollit, kështu që të gjitha pretendimet e paditësit në kërkesë padi jo vetëm që nuk provohen nga ana e tij, por as nuk mund të provojnë se penalizimi i këtij subjekti nga drejtoria jonë është bërë në kundërshtim me ligjin.

Vendimi i dhënë nga Drejtoria e Apelit Tatimor është marrë në analizë të provave dhe dokumentacionit që vetë paditësi ka depozituar pranë kësaj drejtorie dhe pas hetimit administrativ të kryer nga ana e saj, kjo drejtori ka konkluduar që ky penalitet është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 119 pika 1.

Në referim të sa më sipër arrijmë në konkluzionin se Akt – Konstatimi me nr. 0412215 datë 28.09.2015, i nënshkruar pa kundërshtim nga vetë paditësi, është një akt i hartuar në zbatim të procedurës, në bazë të të cilit ka dalë Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. 6350 Prot. datë 01.11.2015, si një akt i hartuar tërësisht në përputhje me ligjin dhe prandaj duhet të lihet në fuqi nga kjo gjykatë pasi edhe neni 138 pika 2 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon shprehimisht se :

Neni 7 I ligjit nr.49/2012 Kompetenca lëndore Gjykatat administrative janë kompetente për:
a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik

Neni 15 E drejta e padisë Të drejtën e ngritjes së padisë e ka:
çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;

Në bazë të Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar Neni 119 pika 1 germa b e ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne R.SH”, I cili percakton qarte se:

1.Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:

(Ndryshuar me Ligj Nr. 10415, dt. 7.04.2011. Botuar ne Fl.z. nr. 51. dt. 03.05.2011).

a) tatimpaguesit e regjistruar si subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatimit mbi fitimin, me gjobë prej 500 000 (pesëqind mijë) lekësh;

b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.

(Ndryshuar me Ligj Nr. 124/2012, dt. 20.12.2012. Botuar ne Fl.z. nr. 177, dt. 09.01.2013).

Ligji nr.9136 date 11.09.2003 'Per Mbledhjen e Kontributeve te Detyrueshme te Sigurimeve Shoqerore ne R.SH', I ndryshuar dhe Udhezimin e Ministrise se Financave nr.26 date 16.04.2009, ne zbatim te tij, eshte percaktuar detyrimi ligjor I cdo tatimpaguesi per te deklaruar ne organin tatimor, nje dite kalendarike perpara fillimit te punes cdo te punesuar, me ane te formularit E-Sig 027/a. Mosdeklarimi ne afatin e percaktuar ligjor te cdo te punesuari per here te pare ose atyre rishtazi, sjell penalizimin e subjektit me gjobe te parashikuar nga neni 119, pika 1 germa a,b te Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne R.SH".

Udhëzimi me nr. 24, i Ministrisë të Financave datë 02.09.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar pika 119.1.e në vijim parashikon se :

119.1 Organet tatimore duhet të kontrollojnë punëdhënësin për të verifikuar nëse deklaratimet dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë të plota dhe të sakta. Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së personit fizik me të cilët ai punon e bashkëjeton ligjërisht), që fillojnë punë për herë të parë të subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklaratim duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve. Në mbështetje të nenit 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", punonjësit e administratës tatimore, të autorizuar me shkrim, kryejnë verifikime e kontrole në vendndodhjen e biznesit lidhur me deklaratimin e numrit të punonjësve. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor çdo të punësuar, që fillon punë për herë të parë te tatimpaguesi apo të punësuar rishtazi pranë tij, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës (përfshirë dhe punonjësit e papaguar të familjes së të vetëpunësuarit me të cilët ai punon e bashkëjeton), përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të papaguara të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimpaguesi përkatës detyrohet të paguajë edhe një gjobë prej:

Neni 45 I ligjit 10433

Mbajtja dhe njoftimi i procesverbalit

1. Inspektori që kryen inspektimin mban procesverbalin e inspektimit, më poshtë

"procesverbali". Nëse veprimet e inspektimit i kanë kryer më shumë se një inspektor, në bazë të një autorizimi të vetëm, ata e mbajnë procesverbalin së bashku. Procesverbali i inspektimit mbahet në tri kopje, të cilat nënshkruhen nga inspektori apo inspektorët që e kanë mbajtur.

Gjykata duke analizuar provat ne perqasje me ligjin cmon se padia eshte e bazuar ne prova dhe ligj. Gjykata ka juridiksion per ceshtjen pasi paditesi ka ezauruar rrugen administrative.

Gjykata cmon se vendimi Njoftim Vleresimit Tatimor per detyrimet tatimore Nr.6350.Prot ,date 01.11.2105 ,ne vleren 100.000 lek ,te Drejtorise Rajonale Tatimore Gjirokaster i lene ne fuqi me Vendimin Nr.39019/3 Prot ,date 29.02.2016 ,te Drejtorise se Apelimit Tatimor ,ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve Tirane eshte nje veprim administrativ i pa bazuar ne fakt ,per pasoje eshte i pavlefshem relativisht sipas nenit 118 i K.Pr.Administrative .

Ne gjykim u provua se pala paditese Dritan Kola eshte denuar administrativisht me aktin Njoftim Vleresimi i Drejtorise Rajonale Tatimore Gjirokaster per mosdeklarim te te punesuarve sipas nenit 119 I ligjit nr.9920.

Gjykata vlereson se akti administrativ nuk bazohet ne nje procesverbal konstatimi ne kundershtrim me nenin 45 i ligjit nr.10433.Procesverbali i konstatimit perben bazen provuese te aktit administrative te nxjerre nga organet tatimore qe sanksionojne shkeljet e legjislacionit tatimor nga subjektet dhe mungese e tij e privon aktin administrative nga bazueshmeria ne themel.

Pala e paditur ka mbajtur nje akt konsatimi i cili nuk permbush kriteret formale te procesverbalit te konstatimit ne kuptim te nenit 45 te ligjit nr.10433.

Nga ana tjeter provohet se shtetaset Gesjana Erindi dhe Malvina Bocia kane kontrate mesimi profesioni me paditesin sipas nenit 17 te K.Punes, pra nuk jane punonjese me pagese ne kuptim te Kodit te Punes dhe per pasoje paditesi nuk ka detyrimin ligjor per deklarimin e tyre Ne keto rrethana Gjykata cmon se padia duhet te pranohet si e bazuar ne prova dhe ligj.

PER KETE ARSYE

Gjykata ne baze te nenit. 40 te ligjit nr.49/2012

VENDOSI


1. Pranimin e padise.
2. Shfuqizimin teresisht te Njoftim Vleresimit Tatimor per detyrimet tatimore Nr.6350.Prot ,date 01.11.2105 ,ne vleren 100.000 lek ,te Drejtorise Rajonale Tatimore Gjirokaster.
3. Shfuqizimin teresisht te Vendimit Nr.39019/3 Prot ,date 29.02.2016 ,te Drejtorise se Apelimit Tatimor ,ne Drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve Tirane .
4. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palëve te paditura.
5. Kunder vendimit nuk lejohet ankim.

U shpall ne Gjirokaster , me date 27.04.2016.

SEKRETARE
ELVANA SHABANI



GJYQAR
ELIDON PAPAZISI



Shpenzimet gjyqesore

Takse regjistrimi	3000	(parapaguar nga paditesi)
Njoftime	4 x 120	= 480 leke (parapaguar nga paditesi)

TOTALI = 3480 LEKE (parapaguar nga paditesi)